



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS SLLAVO-BALLKANIKE**



**PROGRAMI I LËNDËS**  
**Gjuhë e Huaj për qëllime specifike**

**Ngarkesa:** 6 kredite; 60 orë mësimore, 30 seminare, 30 leksione

**Viti / Semestri:** Viti II, semestri I

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Master Shkencor Mësuesi /Gjuhë Turke

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

***Objektivat e përgjithshme lëndore:***

Kursi synon që studentët të dinë të përdorin gjuhën e huaj për të plotësuar nevojat e tyre komunikative në një kontekst të industrisë, në rastin në fjalë të turizmit, të bëhen më me besim gjatë komunikimit, të njohin e të përdorin gjuhë specifike për të zgjidhur nevojat komunikative, të dinë të përdorin terminologjinë specifike në të katër aftësitë gjuhësore ( të folurit, të dëgjuarit, leximin dhe të shkruarit) si dhe të zhvillojnë më tej aftësitë e tyre ndërkulturore.

***Objektivat specifike lëndore:***

- 1.Studentët do mësojnë si të komunikojnë në mënyrë efektive me turistët dhe të jenë ta aftë të japin udhëzime, të shpjegojnë një itinerar të turneut , të zgjidhin ankesat e klientëve në mënyrë të sjellshme, të bëjnë një koment turistik në gjuhë të huaj ,dhe si të shkruajnë njoftime për shtyp ose reklama për destinacione turistike.
- 2.Përdorimi i strategjive të mësimdhënjes që vënë studentin në qendër mundësojnë përvetsimin aktiv të gjuhës për qëllime speciale duke krijuar situata reale punë në fushën e turizmit dhe itenerare që lejojnë përvetimin e përdorimin e gjuhës për nevojat specifike të studentëve.
- 3.Mësimi i strukturave gjuhësorë të nevojshme për përdorim në komunikim me turistët lidhet si me situata reale ashtu dhe me përparimin gramatikor .

***Rezultatet e pritshme:***

- 1.Komunikojë në mënyrë të qartë, të sjellshme dhe profesionale me turistët, duke përdorur terminologji të përshtatshme për sektorin e turizmit në të gjitha aftësitë gjuhësore (të folurit, dëgjimin, leximin dhe të shkruarit).
- 2.Zbatojë gjuhën e huaj në situata reale të lidhura me industrinë e turizmit, si dhënia e udhëzimeve, përshkrimi i itinerarëve, zgjidhja e ankesave, dhe përgatitja e materialeve promovuese (njoftime, reklama, komente turistike).
- 3.Përdorë me kompetencë strukturat gramatikore dhe fjalorin specifik të fushës së turizmit, duke zhvilluar një ndërveprim ndërkulturor efektiv dhe duke treguar besim në situata të ndryshme profesionale.